



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2068/Prot.
16

Patos, më 07/08/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 05 GUSHT 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës nr. 1970 prot., datë 26.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues të bashkisë Patos, , rreth 27 pjesëmarrës (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, përfaqësues nga institucionet arsimore, kryetarë të fshatrave etj)

Takimin hapet nga zv/ kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli

Zv/ kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1970 prot., datë 26.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit për zhvillimin e dëgjësës publike lidhur me Planin e Arsimit Parauniversitar 2026-2028, sot jemi mbledhur për të marr komentet dhe rekomandimet lidhur me draft planin e Arsimit Parauniversitar 2026-2028 të hartuar për bashkinë Patos.

Gjithashtu lidhur me këtë dëgjese publike, dua të thekoj që njoftimi lidhur me këtë dëgjese publike është bërë për periudhën 2025-2027, por në bashkëpunim me grupin e punës është vlerësuar që periudha e këtij dokumenti të jetë 2026-2028. Gjithashtu kërkojmë që ky ndryshim të bëhet me dije dhe të reflektohet edhe procedurat në vazhdim. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin e materialit dhe jemi të hapur për të marr komentet dhe rekomandimet tuaja.



**Zv/ Kryetare
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-
2028”
Gusht 2025**

Drejtores e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj- përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim të detyrave funksionale nuk mund të mungonte një dokument strategjik siç është Planin i Arsimit. Këto plane janë hartuar me ekspertizë të caktuar dhe në një kohë ku ligjet janë gjithmonë në ndryshim, bashkitë edhe në kuadër të granteve të performancës më vjen shumë mirë që bashkia Patos u angazhua në hartimin e këtij dokumenti.



**Drejtores
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-
2028”
Gusht 2025**

Të gjitha sfidat kanë të mëdha dhe sidomos ato të ndryshimeve demografike. Dua të theksoj edhe diçka tjetër para se të filloj me prezantimin e materialit. Në njoftim keni marrë ftesën për tu konsultuar për një dokument për periudhën 2025-2027, por në vazhdimësi të punës dhe në bashkëpunim me grupin e periudhës kemi vendosur që viti i zbatimit të jetë 2026-2028

duke e lidhur kështu edhe me PBA e bashkisë. Struktura e këtij dokumenti fillon me një vlerësim demografik pasi ne fillimisht kemi bërë një përshkrim të profilit demografik duke analizuar arsimin, kemi hartuar planin e objektivave të zërthyer në masa përkatëse, është vendosur buxheti dhe vlerësimi i kapitalit. Metodologjia dhe analiza e të dhënave që është ndjekur proces gjithëpërfshirës me mbledhje dhe analizë të të dhënave nga terreni. Përdorimi i të dhënave demografike nga Censusi 2023 për profilin e komunitetit. Është bërë analiza e gjendjes në çdo institucion arsimor sipas: infrastrukturës, stafit, aksesit, përfshirjes. Identifikimi i nevojave prioritare për investime dhe përmirësim shërbimi dhe konsultime me strukturat drejtuese dhe aktorë lokalë. Gjithashtu vlerësimi me indikatorë të matshëm për monitorimin e progresit.

Vizioni i këtij plani është të garantojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe cilësor për çdo fëmijë në Patos. Fokusi është të investimet e qëndrueshme në infrastrukturë, digjitalizimi dhe modernizimi i mësimdhënies. Zhvillimi profesional i stafit mësimor dhe edukativ për rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor. Përkujdesje sociale, përfshirje të barabartë dhe mbështetje për grupet në nevojë. Fuqizimi i komunitetit shkollor dhe nxitja e formimit qytetar të nxënësve përmes pjesëmarrjes aktive.

Qëllimet strategjike të këtij plani janë tre.

Q1: Të zhvillohet dhe modernizohet infrastruktura arsimore nëpërmjet:

- Sigurimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe funksional për çdo institucion arsimor
- Investime sistematike në infrastrukturë, kushte higjeno-sanitare, ngrohje, rrethim objekteve dhe materiale didaktike, etj.

Q2: Të rritet mirëqenia dhe cilësia e zhvillimit të fëmijëve nëpërmjet:

- Ofrimit të mbështetjes psiko-sociale dhe edukimit të personalizuar
- Përfshirjes e fëmijëve në nevojë dhe angazhimi i familjes në procesin arsimor

Q3: Të promovohet pjesëmarrja aktive dhe formimi qytetar i fëmijëve nëpërmjet:

- Zhvillimi i aktiviteteve jashtëmësimore për sport, kulturë, krijimtari dhe mjedis
- Ndërtimi i ndjenjës së përkatësisë dhe bashkëpunimit në komunitetin shkollor

Shtyllat udhëheqëse të vizionit të këtij plani kanë të bëjnë me:

Përfshirje dhe barazi: Asnjë fëmijë jashtë sistemit arsimor, me fokus të veçantë tek fëmijët e moshës 3–6 vjeç dhe grupet në nevojë. Politika për barazi gjinore, përfshirje të komuniteteve romë dhe egjiptiane, dhe mbështetje për fëmijët me aftësi ndryshe.

Cilësi dhe zhvillim profesional: Rritja e standardeve të mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të stafit edukativ dhe ndihmës.

Përmirësimi i metodologjive të të nxënit përmes qasjes aktive, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt të ardhmes.

Infrastrukturë dhe mjedis edukues: Rikonstruktimi dhe zgjerimi i kopshteve dhe shkollave për të garantuar mjedise të sigurta, të pastra dhe funksionale. Pajisje bashkëkohore didaktike dhe digjitale në çdo institucion.

Zhvillim i hershëm dhe kujdes parashkollor: Investim në arsimin e hershëm për fëmijët 0–6 vjeç si themel i suksesit në edukimin e mëtejshëm. Rritje e kapacitetit të kopshteve publike dhe partneritete me sektorin privat.

Bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin: Fuqizimi i rolit të prindërve në procesin edukativ përmes forumeve, trajnimeve dhe këshillave të kopshtit/shkollës. Nxitja e ndjenjës së përkatësisë dhe kujdesit të përbashkët për institucionet arsimore.

Qëllimet Strategjike të këtij plani po i zbërthej dhe po ndalem te pjesa e objektivave.

Objektivi 1 lidhet me sigurimin e një mjedisi të sigurt, funksional dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë në institucionet arsimore dhe parashkollore. Objektivi 1.1: Garantimi i funksionimit të përditshëm të institucioneve arsimore përmes angazhimit të stafit edukator dhe atij ndihmës, sigurimit të kushteve bazë si mirëmbajtja, ngrohja, uji, ushqimi, higjiena dhe transporti.

Objektivi 1.2: Investime për rikonstruksione, zgjerim kapacitetsh dhe sisteme informacioni për menaxhim dhe transparencë. Objektivi 2 lidhet me zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar. Objektivi 2.1: Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore. Objektivi 2.2: Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale. Objektivi 2.3: Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

Objektivi 3 lidhet me nxitjen e talenteve, përfshirjes kulturore dhe ndjesisë së përkatësisë përmes aktiviteteve edukative jashtëkurrikulare. Objektivi 3.1: Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale për zhvillimin emocional dhe bashkëpunimin mes fëmijëve. Objektivi 3.2: Ngritja e partneriteteve me aktorë komunitarë për të pasuruar ofertën edukative dhe lidhjen me jetën komunitare.

Aktivitetet që përfshin ky plan listohen si më poshtë: Aktivitetet: O1.1: Garantimi i funksionimit të përditshëm të institucioneve arsimore përmes angazhimit të stafit edukator dhe atij ndihmës, sigurimit të kushteve bazë si mirëmbajtja, ngrohja, uji, ushqimi, higjiena, transporti dhe kancelaria. Pagat dhe sigurimet: Mbështetje financiare për personelin arsimor

dhe mbështetës (paga + sigurime). Mirëmbajtje infrastrukture: Ndërhyrje për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së ambienteve. Higjiena: Pastrim ditor dhe përmirësim i standardeve sanitare në shkolla dhe kopshte. Ngrohja: Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes për kushte komode. Fikset e zjarrit: Pajisje, kontroll dhe kolaudim për siguri nga zjarri. Dokumentacion administrativ: Furnizim me regjistra dhe formularë për funksionimin e brendshëm. Mjete didaktike: Pajisje bashkëkohore për mbështetje të mësimdhënies dhe zhvillimit të nxënësve. Për këtë pjesë vlen për tu përmenduar dhe theksuar që ne kemi marrë angazhimi dhe mundohemi ta reflektojmë të PBA. Ushqimi në kopshte: Sigurimi i vakteve të shëndetshme për fëmijët në institucionet parashkollore. Dezinfektimi: Zbatim i rregullt i shërbimeve për sigurinë shëndetësore. Transporti institucional: Mjete për nevoja logjistike të institucioneve arsimore. Aktivitetet: O1.2: Investime për rikonstruksione, zgjerim kapacitetesh dhe sisteme informacioni për menaxhim dhe transparencë. Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë. Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor, Investime për pajisje në godinat e arsimit bazë dhe parashkollor, Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit të mesëm të përgjithshëm, Investime për pajisje në godinat e arsimit të mesëm të përgjithshëm, Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat: Dixhitalizim. Aktivitetet për O 2.1: Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore. Aktivitetet për O 2.2: Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale. Fushata për prindërit: Informim dhe edukim i prindërve në zonat me akses të kufizuar mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.

Identifikim dhe mbështetje: Bashkëpunim me punonjës socialë për të evidentuar dhe ndihmuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për arsye sociale ose ekonomike.

Fuqizim strukturash këshilluese: Aktivizimi i bordeve të shkollave, këshillave të prindërve dhe komisioneve të sigurisë në shkolla dhe kopshte.

Përfshirje e komunitetit: Angazhimi i prindërve dhe organizatave lokale në vendimmarrje dhe monitorim të arsimit për të rritur transparencën dhe bashkëpronësinë.

Aktivitetet: O3.1: Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale për zhvillimin emocional dhe bashkëpunimin mes fëmijëve. Java Evropiane e Sportit (23–30 Shtator) Loja popullore, ushtrime në natyrë, gara me biçikleta dhe aktivitete lëvizore, java Olimpike (Prill–Maj) Stafeta, gara vrapimi dhe aktivitete sportive mes kopshteve, Dita e të Drejtave të Fëmijëve (20 Nëntor), Biseda dhe ekspozitë: “Të drejtat e mia”, aktivitete në natyrë, Dit, Kundër Bullizmit (21 Nëntor), Biseda dhe aktivitete ndërgjegjësuere për fëmijët, Dita e

Alfabetit Shqiptar, Postera dhe koncert për gjuhën shqipe, Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara (3 Dhjetor), Loja me role, biseda dhe ekspozitë nga fëmijët me aftësi ndryshe. Gjithashtu Dita Botërore e Gjuhës Amtare, vizita në bibliotekë dhe aktivitete për gjuhën shqipe, dita Botërore e Ujit (22 Mars), biseda, postera dhe eksperimente mbi rëndësinë e ujit, dita Ndërkombëtare e Romëve, biseda mbi zakonet, traditat dhe përfshirjen e fëmijëve romë, dita Botërore e Librit (23 Prill), vizita në bibliotekë, aktivitete krijuese dhe fushatë “Dhuro një libër”, dita Botërore e Mjedisit (5 Qershor), aktivitet riciklimi, mbjellje lulesh, ekspozita dhe ekskursionet, yjet e Vallëzimit dhe konkurs vallëzimi midis kopshteve të qytetit. Edhe monitorimi dhe vlerësimi do të bëhet sipas një sistemi të bazuar në indikatorë të matshëm dhe pjesëmarrje të aktorëve, raportime vjetore dhe analiza të vazhdueshme për përmirësim, përfshirjes së komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile. Këto ishin pak a shumë detajet e këtij plani. Jemi të hapur për çdo pyetje apo koment për përmirësim që mund të keni.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- Unë kam një pyetje. Plani ishte vetëm për



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar
2026-2028”
Gusht 2025**

arsimin parashkollor? Sepse ju folët shumë për kopshtet, por jo për shkollat?

Drejtoresha e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj– Plani është për arsimin parauniversitar mund ti drejtohen dhe materialit të plotë. Ky plan nuk është vetëm për kopshtet.



**Drejtoresha
Znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-
2028”
Gusht 2025**

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj– A keni ju një informacion se sa ka rënë numri i nxënësve në arsimin parashkollor për të gjithë territorin e bashkisë Patos? A është rritur numri i nxënësve apo është zvogëluar? Kjo pyetje vlen për të tre njësitë administrative. Lidhur me këtë thatë që prioritet i këni dhënë transportit. Si e keni parashikuar këtë prioritet sepse ju kishit një pikë që kishit planifikuar transport? Problematika më e madhe që shikoj është transporti nga banesë për në kopshtin më të afërt. Një nga elementet e tjera që unë mendoj që duhet të trajtohet janë edhe fëmijët me aftësi ndryshe. Nuk e di çfarë keni parashikuar për këtë element. Nga informacioni që unë kam duhet të jetë rritur numri i këtyre fëmijëve dhe një fëmij parashkollor me aftësi ndryshe e ka të vështirë të aksesoj kopshtin. Ne kemi një mjet transporti të linjës Patos i vjetër që mund të marr fëmijët dhe ti sjell te institucioni. Shkolla Mustafa Matohiti është një nga shkollat që është rikonstruktuar dhe niveli i nxënësve ka rënë shumë pasi kanë problem me transportin. Ka ndonjë ndërhyrje konkrete bashkia.



**Anëtar i Këshillit Bashkiak,
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar
2026-2028”
Gusht 2025**

Drejtoresha e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj– Lidhur me çështjet demografike kjo është një sfidë që prek shumë vende. Treguesit janë që nga 2018-2025 dhe shifrat flasin duke treguar që ka numër në rënie të nxënësve dhe fëmijëve. Jemi në kushtet që ne duam të ofrojmë shërbim dhe në territorin e bashkisë Patos institucionet arsimore nuk janë shumë larg nga qendrat e banuara apo nga njëra tjetra. Vetëm shkolla e Drenies është mbyllur deri tani. Jemi të ndërgjegjshëm që nuk mund të mbajmë institucione arsimore nëse nuk plotësojnë numrin e nxënësve. Bashkia është e hapur dhe e gatshme për bashkëpunim edhe për monitorimin e situatave. Ofrimi i shërbimit nuk është mohuar asnjëherë. Transportin e kemi lënë sipas vendimit të 1 Mars 2003 i cili ngarkon njësitë e vetqeverisjes për transportin. Nuk mundet një nxënës që e ka afër qendrës së banimit të përfitoj kompensim të distancës. Distanca është e njëjtë për kompensim edhe për arsimin

parashkollor. Njësitës konfirmojnë distancën, ndërsa rimbursimi bëhet në bashkëpunim me ZVA. Nuk kemi akoma një kuadër ligjor të miratuar për të ofruar shërbimin e ushqimit dhe transportit. Për sa i përket fëmijëve me PAK nuk është në rritje, por në rritje është numri i fëmijëve me një diagnoz të caktuar në këto institucione. Në pagesën që kanë këta fëmija kanë disa lehtësira.



**Drejtoreshë
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-
2028”
Gusht 2025**

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Për pjesën e shkollës Mustafa Matohiti është



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar
2026-2028”
Gusht 2025**

diskutuar dhe me mësuesit që transporti i furgonit që kemi aktualisht do të vijë në ndihmë nxënësve në oraret e shkollës dhe do të akomodojë në shtëpi.

Anëtar i Këshillit Patos, z. Eduart Faslliaj- Nuk isha dakord lidhur me këtë pjesën e distancës që ju thatë. Drenia nga Gjynoqara është 4 km dhe fëmijët nuk shkojnë dot në institucionet arsimore. Mjet transporti nuk ka. Nga Siqeca distanca është e madhe, edhe në fshatin Belinë kanë problematik në shkollë pasi nuk kanë një kënd të vogël lojërash që edhe nxënësit të luajnë. Kemi mundësi që edhe bashkia të ndërhyjë për transportin pasi vetëm kështu mund të zgjidhet ky problem. Fëmijët duhet të shkojnë në institucione arsimore pasi i shërbejnë të ardhmes dhe shoqërisë. Kërkoj nga ju që ti jepni një zgjidhje pjesës së

transportit. Edhe për shkollat duhet të investohet psh në shkollën Mustafa Matohiti duhen kabinete sepse nuk ka.



**Anëtar i Këshillit Patos
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar
2026-2028”
Gusht 2025**

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj- Një pjesë e mirë e shkollave janë rikonstruktuar, por përsëri kanë problematika. Ne kemi problem në shkollën “Muhamet Shehu” pasi nuk ka bazë për kabinetet as banka dhe as karrige. Gjithashtu nuk ka stola ku të qendrojnë nxënësit në oborr. Kjo duhet parë nga ana e bashkisë për ndërhyrje. Eddhe pjesa e mirëmbajtjes së shkollave duhet të ndryshoj dhe të bëhet gjatë periudhës së verës para së të filloj procesi mësimor.



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-
2028”
Gusht 2025**

Drejtoresha e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj – Për vitin e ardhshëm jemi në rikonstrukcion për shkollën “Sotir Çapo” dhe gjithashtu synojmë për



**Drejtoresha
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028”
Gusht 2025**

rikonstrukcion të kopshtit nr. 2 dhe urojmë shumë që numri i fëmijëve të rritet. Për kabinetet në si njësi e vetqeverisjes vendore ndihmojmë në pajisjen me materiale edhe pse si kompetencë kryesore është ministria. Për mirëmbajtjen ka një procedurë që duhet ndjekur dhe do e rishikojmë. Angazhimi ynë është maksimal lidhur me mirëmbajtjen dhe në disa institucione ka filluar procesi.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli - ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj. E deklarojmë të mbyllur këtë dëgjese publike dhe uroj të takohemi në dëgjese të tjera.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba